

Vendim nr. 223 datë 18.09.2025

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, në datën 18.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (M) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: MANJOLA HYSENAJ dhe SHOQËRIA “HOTEL DOMUS” SH.P.K., të përfaqësuar nga avokatët Jola Frashëri dhe Jordan Daci, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-148, datë 30.01.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pika 1, 5, 7, 11, 15, 17, 18, 28, 29, 30, 31, 33, 41, pika 1, 42, 43, 59, 116, 122, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6/1, 7, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 2 i Protokollit nr. 7 të saj, ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 75, datë 14.04.2022 për një organizatë kriminale, të ashtuquajtur “Çopja”, të përfshirë në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike, duke hetuar veprat penale të vrasjes me paramendim, në tentativë, në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të mbajtjes pa leje të armëve në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; të përkrahjes së autorëve të krimit, të parashikuara nga nenet 78 (paragrafi 2) e 22, 278 e 28 (paragrafi 4), 333/a, 334 dhe 302 të Kodit Penal (KP). Gjatë hetimeve paraprake, Prokuroria e Posaçme ka konstatuar se një pjesë e të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti kriminal i trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike është investuar në Shqipëri, kryesisht në sektorin e pasurive të paluajtshme në disa qytete, nëpërmjet blerjes së pasurive të paluajtshme (apartamente, vila, bare e restorante dhe sipërfaqe toke), si dhe nëpërmjet injektimit të shumave monetare të konsiderueshme *cash* për ndërtimin e komplekseve të banimit në disa qytete.

2. Në datën 23.07.2024 Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë*), me kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive ndaj disa pasurive të paluajtshme, midis të cilave edhe të 8 pasurive të paluajtshme, të regjistruara në emër të kërkueses Manjola Hysenaj dhe të shoqërisë “Hotel Domus” sh.p.k., të regjistruar në emër të kërkueses, me të njëjtin emër, me argumentin se ekzistonin dyshime të arsyeshme se ato pasuri ishin gjeneruar përmes të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal dhe disponimi i lirë i tyre mund të rëndonte ose të zgjaste pasojat e veprës penale.

3. Me vendimin nr. 467, datë 29.07.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, në dhomën e këshillimit, ka pranuar kërkesën e prokurorisë, duke ngarkuar me administrimin e tyre Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave (AAPSK). Ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkesa e paraqitur plotësonte njëkohësisht dy kushtet kumulative të parashikuara nga neni 274 i Kodit të Procedurës Penale (KPP): (i) elementin *fumus delicti*, pasi ekzistonin dyshime se pasuritë ishin produkt i veprës penale; (ii) elementin *periculum in mora*, pasi ekzistonte rreziku se lënia e lirë e pasurive mund të rëndonte pasojat e veprimtarisë kriminale. Vendimi gjyqësor i sekuestrimit është vënë në ekzekutim bazuar në urdhrin e datës 01.08.2024 të prokurorit.

4. Ndonëse të dyja kërkuestet kanë paraqitur ankim, vendimi është miratuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Apelit*), me

vendimin nr. 43 (87-2024-267), datë 19.09.2024, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-148, datë 30.01.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të tyre.

5. Në datën 25.03.2025 kërkesja Manjola Hysenaj i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë me kërkesë për ndryshimin e urdhrit të prokurorit për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit për një nga pasuritë dhe lejimin e saj e të fëmijëve të mitur që të vazhdojnë të banojnë në të. Kjo kërkesë është pranuar pjesërisht nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë me vendimin nr. 177, datë 28.03.2025 (*vendimi nr. 177/2025*), e cila ka urdhëruar pezullimin e përkohshëm të urdhrit të ekzekutimit të prokurorit, si dhe lënien në ruajtje të pasurisë “Dupleks D1” kërkeses për të banuar së bashku me dy fëmijët e saj, deri në disponimin përfundimtar nga organi procedues. Ndaj vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar ankim.

6. Në datën 21.05.2025 të dyja kërkeset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 28.05.2025.

II

Pretendimet e kërkueseve

7. **Kërkeset**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë u janë cenuar:

7.1. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi ndërhyrja nuk është e bazuar në ligj (nenin 274 të KPP-së), në kushtet kur kërkeset nuk janë subjekte të procedimit penal dhe pasuritë janë fituar në respektim të ligjit. Për më tepër, kërkesja e dytë, shoqëria “Hotel Domus” sh.p.k., është edhe në mirëbesim. Po kështu, mungon dyshimi i arsyeshëm për kufizimin e së drejtës së pronës, pasi Prokuroria e Posaçme nuk ka kryer verifikimet e nevojshme. Sekuestrimi është vendosur për shkak të bashkëjetesës së kërkeses Manjola Hysenaj me një prej të dyshuarve, por bashkëjetesa është ndërprerë prej më shumë se një dekadë. Kufizimi i së drejtës së pronës nuk ka respektuar parimin e proporcionalitetit, pasi vendimet e gjykatave nuk kanë përcaktuar qartë nevojën për kufizimin e garancive kushtetuese.

- 7.2. *E drejta për jetë familjare dhe për banesë*, e garantuar nga neni 8 i KEDNJ-së, pasi vendosja e sekuestros preventive ka cenuar të drejtën e kërkueses Manjola Hysenaj, e cila ka dy fëmijë, për të gëzuar banesën e saj deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga gjykata. Edhe pse nuk disponon banesë tjetër, asaj i është kërkuar të lirojë banesën ose ta marrë atë me qira nga AAPSK-ja. Ndonëse gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit organi i ndjekjes penale ka hequr dorë nga sekuestrimi i banesës, kërkimi i tij nuk është pranuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit.
- 7.3. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:
- 7.3.1. *Parimi i prezumimit të pafajësisë, e drejta për të heshtur dhe e drejta për t'u mbrojtur*, pasi në dosjen gjyqësore ndodhen vetëm informacione nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, ndërsa pjesa tjetër janë biseda përmes platformave SkyEcc dhe Echrochat, të pakonfirmuara nga një gjykatë e caktuar me ligj, të cilat, edhe nëse do të cilësoheshin të ligjshme, nuk përbëjnë prova, por mjete për kërkimin e provës. Dy kërkuestet nuk janë persona të dyshuar, ndaj atyre nuk u duhej kaluar barra e provës për të justifikuar pasurinë. Kjo shkelje nuk është riparuar nga Gjykata e Lartë.
- 7.3.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e krijuar me ligj*, pasi, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueseve dhe duke mos marrë parasysh provat e paraqitura prej tyre për burimin e ligjshëm të pasurive, Gjykata e Posaçme e Apelit është treguar e njëanshme.
- 7.3.3. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykatat kanë vendosur sekuestrimin e disa pasurive, për të cilat ishte dhënë vendim gjyqësor në vitin 2016, sipas ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar (ligji nr. 10192/2009), duke shkelur në këtë mënyrë edhe të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim.
- 7.3.4. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë argumentuar për kriterin e rrezikut të disponimit të lirë të pasurive dhe as nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueseve që lidheshin me kriteret e subjektit të posaçëm dhe shpërpjesëtimin për të ardhurat. Administratori i pasurive nuk përkon me emrin e caktuar nga gjykata e shkallës së parë në vendim dhe ky i

fundit u është njoftuar kërkueseve i paarsyetuar me shkurtim vendimi. Gjykata e Posaçme e Apelit nuk ka argumentuar për rëndësinë e provave të paraqitura nga kërkueset, të cilat nuk u morën në shqyrtim prej saj. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për të gjitha pretendimet e ngritura në rekurs, përfshirë ato për paligjshmërinë e vendimit të gjykatës së apelit në rrëzimin e kërkesës për sa i përket shtëpisë së banimit, si dhe për parimin e gjësë së gjykuar. Gjykata e Lartë ka trajtuar raste të ngjashme në mënyrë të ndryshme, ndaj ka cenuar edhe parimin e barazisë përpara ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitetin e kërkueseve

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

10. Në çështjen konkrete, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon të ndalet në analizën e legjitimitetit *ratione materiae*, duke shtruar për diskutim fillimisht se cili është objekti i ankimit kushtetues individual i të dyja kërkueseve. Ankimi, i përpiluar me ndihmën e avokatit, ka në objektin e tij vetëm kërkimin për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, ndërsa në përmbajtjen e tij janë ngritur pretendime ndaj vendimeve të gjykatave të faktit dhe procesit të zhvilluar prej tyre. Megjithatë, përmbajtja e ankimit rezulton t'i referohet në disa pjesë edhe akteve të apelit ose rekursit, si kërtime që i drejtohen me radhë gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë, pra jo si pretendime të ngritura për t'u shqyrtuar nga Gjykata. Në këtë situatë, duke mbajtur në konsideratë objektin formal të ankimit kushtetues individual, si dhe faktin se të dyja kërkueset janë të asistuara profesionalisht nga avokati, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual ka në objektin e tij vetëm kërkimin ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë, ndaj do të shqyrtohen ato pretendime që lidhen me atë vendim.

11. Kërkuesja Manjola Hysenaj ka ngritur, ndër të tjera, edhe pretendimin për cenimin e së drejtës e saj për jetë private dhe banesë, me argumentin se Gjykata e Lartë nuk ka riparuar shkeljen e gjykatave të faktit, që lidhej me rrethanën që një prej pasurive të sekuestruara asaj i shërbente për qëllime banimi, si nënë me dy fëmijë të mitur. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se me vendimin gjyqësor nr. 177/2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është vendosur që kësaj kërkueseje t'i lihet në ruajtje pasuria "Dupleks D1", me arsyetimin se shteti ka detyrime pozitive për të respektuar të drejtën për jetë familjare dhe banesë, në kushtet kur ajo ka dy fëmijë të mitur. Vendimi gjyqësor nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve, përfshirë Prokurorinë e Posaçme. Në këtë situatë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se gjykatat e zakonshme, në përmbushje të rolit të tyre subsidiar, kanë marrë masat për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese, ndaj pretendimi i ngritur nga kërkuesja nuk mund të merret në shqyrtim.

12. Në vijim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, të dyja kërkueset kanë pretenduar se u janë cenuar e drejta e pronës dhe e drejta për proces të rregullt ligjor (në aspektet e prezumimit të pafajësisë, së drejtës për të heshtur, së drejtës për t'u mbrojtur, së drejtës për një gjykatë të paanshme, parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsytimit). Sipas kërkueseve, këto të drejta kushtetuese të cenuara nga vendimmarrja e gjykatave të faktit, nuk janë riparuar nga Gjykata e Lartë, e cila me vendimin e saj nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar të gjitha pretendimeve të tyre. Mbledhja e Gjyqtarëve, nisur nga fakti se objekti i ankimit është vendimi i Gjykatës së Lartë, çmon t'i shqyrtojë pretendimet e kërkueseve në

këndvështrim të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si aspekt i së drejtës për proces të rregullt ligjor të garantuar nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

13. Gjykata ka pohuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Zbatimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në lidhje me vendimet e mospranimit të rekursit, Gjykata ka theksuar se ato vendime mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa në thelb shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se pretendimet e kërkueseve për cenimin e së drejtës së pronës, si dhe së drejtës për proces të rregullt janë listuar në pjesën hyrëse të vendimit si shkaqe të rekursit të tyre (*shih paragrafin 17 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në pjesën arsyetuese, Gjykata e Lartë, pjesës dërrmuese të shkaqeve të rekursit i është përgjigjur me formulimin standard të kufizuar se shkaqet e parashtruara në rekurs nuk janë të tilla që të paraqesin rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk konstatohen shkelje procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimi objekt rekursi të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 25 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ky arsyetim i kufizuar, i kombinuar me listimin e shkaqeve të rekursit, shpreh, në thelb, arsyet e mospranimit të rekursit dhe nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

16. Për më tepër, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka referuar gjerësisht arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit, e cila u ka dhënë përgjigje të

arsyetuar pretendimeve të kërkueseve, përfshirë atë për cenimin e parimit të sigurisë juridike me argumentin se pasuritë e sekuestruara i ishin nënshtruar më parë shqyrtimit gjyqësor. Konkretisht, në vendim është arsyetuar se me ligjin nr.35/2017, KPP-ja ka pësuar ndryshime, sipas të cilave, vendimi për pushimin e procedimit pasuror mund të ndryshojë, kur dalin ose zbulohen të dhëna ose prova të reja, ndaj në rastin konkret nuk gjen zbatim parimi ‘gjë e gjykuar’ (*shih paragrafin 14.16. të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

17. Gjithashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se Gjykata e Lartë, në pjesën arsyetuese të vendimit të saj, i ka dhënë përgjigje në mënyrë të shprehur pretendimit të kërkueseve për cenimin e së drejtës së pronës për shkak se sekuestrimi është vendosur pa ligj (pasi nuk plotësohen kushtet e nenit 274 të KPP-së dhe kërkueset nuk janë subjekte të procedimit penal), duke arsyetuar se janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive: (i) ekzistenca e indicieve që lidhin pasuritë me veprat penale, si dhe verifikimi i faktit të rëndimit ose zgjatjes së pasojës së veprës penale, apo lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale; (ii) rreziku i vonesës deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykuar, që konsiston në shmangien e ardhjes ose zgjatjes së pasojave nga vepra penale, apo të lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale. Sipas saj, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes të pranuar nga gjykatat e faktit, vendimmarrjes së tyre, në raport edhe me shkaqet e paraqitura në rekurset respektive, vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është dhënë në përputhje me nenin 274 të KPP-së. Dyshimet janë mjaftueshëm të argumentuara bazuar në provat e marra deri në këtë fazë dhe në përputhje me ligjin procedural penal. Po kështu, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se objekt i sekuestrimit preventiv mund të jetë çdo e mirë (pasuri) - për këdo që i përket - dhe, për rrjedhojë, edhe për një person që nuk ka lidhje me krimin, për sa kohë që, megjithëse në mënyrë indirekte, kjo pasuri është e lidhur me krimin dhe, nëse lihet lirisht në dispozicion, mund të përbëjë një rrezik për rëndimin ose zgjatjen e pasojave të veprës penale ose lehtësimin e kryerjes së fakteve të mëtejshme penale (*shih paragrafët 21-23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

18. Në këtë pikë, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë janë parashtruar gjerësisht rrethanat e faktit, siç janë pranuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit, duke dhënë detaje të veprave penale, të transaksioneve financiare, të pasurive dhe të lidhjes që ato pasuri kanë me llojin e veprave penale, përfshirë rrezikun që mund të vinte nga vonesa në kuptimin e zgjatjes së pasojave ose lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale (*shih paragrafin 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në këtë situatë, vendimi i Gjykatës së Lartë,

në thelb, edhe pse me arsyetim të kufizuar, ka shprehur arsyen e mospranimit të shkaktuar të rekursit, kufizimit pa ligj të pronës.

19. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se argumentit të kërkuueseve për parimin e proporcionalitetit, Gjykata e Lartë, përveçse e ka listuar atë si shkak rekursi në pjesën hyrëse të vendimit të saj, i është përgjigjur në mënyrë të shprehur se në këtë rast interesi publik justifikon masën e marrë; kufizimet në disponimin e pasurive të sekuestruara janë të parashikuara në ligj, janë të nevojshme dhe në përpjesëtim me rrethanat konkrete që e kanë diktuar marrjen e masës së sekuestros preventive (*shih paragrafin 23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për këtë arsye, me të njëjtin arsyetim, si më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit për cenimin e parimit të proporcionalitetit.

20. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimet e kërkuueseve janë haptazi të pabazuara, ndaj ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash¹,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

¹ Gjyqtaret Holta Zaçaj dhe Sonila Bejtja votuan për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin se pretendimi i kërkuueseve për mungesën e dyshimit të arsyeshëm për kufizimin e së drejtës së pronës nuk është haptazi i pabazuar.